


REPUBLIKA E KOSOVËS - RIKUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - URBETI QYKUBIT - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Numri i Dokumentit / Doc. No. 01	Nr. Prot. / Prot. No. 1059/3
Nr. i Fletësive / No. Pages - 92 -	Data / Date 06 / 04 / 2018
Prishtinë / a	



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS
 VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
 MINISTERSTVO KULTURU, OMLADINE I SPORTA
 MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

Raport për Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj

Plani dhe aktivitetet e realizuara Nga: zv. Ministri Rexhep Mazrreku -
 MKRS

Prishtinë, 2018

Parathënie

Në materialin e më poshtëm është prezantuar puna e bërë në këtë tremujor, përkatësisht realizimi i planit të punës për muajin *Janar, Shkurt, Mars 2018*. Ky program i imi i zv. Ministrit të MKRS-së është realizuar më shumë angazhim, përkushtim duke pasur përkrahje të fuqishme nga bashkëpunëtorët e mi tekniko-administrativ që natyrisht u jam mirënjohës për punën dhe koordinimin e vizitave dhe punët shtesë që kanë dalur nga MKRS dhe ministri Gashi. Lirisht mund të konstatojë atë që e kam planifikuar është realizuar mbi 85% ndërsa pjesa e parealizuar është mbete për shkak të pengesave teknike si mosfunksionimi për më shumë se një muaj i ueb faqeve zyrtare të komunave kanë pasur riformatim në ueb faqet e tyre, mungesa e kryetarëve të disa federatave kanë qenë të angazhuar jashtë vendit, mos përgjigja në e-mail nga disa komuna për të organizuar takime të përbashkëta ,mungesa e numrave të telefonave disa komunave dhe drejtorëve komunal të DKRS-ve por jemi shumë të gatshëm që takimet e planifikuara në këtë tre mujor që nuk janë mbajtur do të realizohen në muajt në vazhdim. Takimet që i kemi mbajtur jemi njoftuar me gjendjen e federatave, klubeve, Fakulteti i Shkencave Sportive, pengesat dhe vështirësitë në realizimin e planeve të punës ku nga secili takim është prezantuar mënyra apo metodat e punës, gjendja se si dilet dhe të ecët përpara, eliminimi i të metave, pengesave dhe vizioni - plani afatmesëm për të ardhmën.

Ne me këto synime, vizione dhe kërkesa do të njoftojmë Ministrin dhe Departamentin për Sport dhe sekretarin nga ana administrative dhe ligjore si dhe zyrën për informim. Jemi shumë të përkushtuar që planin e punës për vitin 2018-të të realizojmë me përpikëri.

(Zv. Ministër: Rexhep Mazrreku).

Përmbajtje

Parathënie

Përmbajtje

1.	Vizita të realizuara me Federata dhe Klube	7
1.1.	Takim me DKRS në Malishevë dt. 26.01.2018.....	7
1.2.	Federata Skitare e Kosovës dt.02.02.2018	8
1.3.	Federata e Hendbollit e Kosovës dt.07.02.2018	9
1.4.	Federata e pingpongut e Kosovës dt.15.02.2018.....	10
1.5.	Klubi i Futbollit Prishtina dt. 26.02.2018.....	11
1.6.	K F 2 Korriku – Prishtinë dt.01.03.2018.....	12
1.7.	Federata e Karatesë e Kosovës dt.02.03.2018	13
1.8.	Federata e Atletikës e Kosovës dt.05.03.2018	14
1.9.	Federata e Boksit e Kosovës dt.06.03.2018	15
2.	Fakulteti i Shkencave Sportive – Prishtinë dt.08.03.2018.....	16
3.	Komuna e Junikut takim i realizuar më dt.14.03.2018.....	17
4.	Komuna e Klinës takim i realizuar më dt.15.03.2018.....	18

**Takime dhe vizita të ndryshme të realizuara në zyre dhe në teren nga:
zv. Ministër Rexhep Mazrreku**

- Takim i realizuar në Malishevë me ftesë të klubit të Futbollit të Femrave Malisheva dt.28.12.2017
- Takim i realizuar me ftesë të DKRS-s Malishevë me rastin e zgjedhjes së Sportistit të vitit 2017, ku ishin të pranishëm Kryetari i Komunës z. Begaj, drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, veteran të Arsimit, përfaqësues të sportit dhe sportistë dt.30.10.2017
- Takim i thirrur nga Ministri Kujtim Gashi në zyre të ministrit dt.12.01.2018
- Takim i zv. Ministrit Rexhep Mazrreku me drejtorin e departamentit të Sportit Ibër Alaj dt.17.01.2018
- Vizitë në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, me ftesë të drejtorit të BKK z. Gajraku, në 550-të vjetorin e vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dt.17.01.2018
- Takim i organizuar për Kryesinë e klubit të Futbollit të Femrave KFF Malisheva, në këtë takim ishin : Kryetari i klubit Albert Krasniqi, trajneri Valmir Krasniqi Zv. trajnere Qëndresë Thaçi dhe trajnerën Arbnore Berisha dt.26.01.2018
- Vizitë nga përfaqësuesit e Lidhjes së shoqatave shqiptare në Suedi: Murat Koci kryetar, Hazbi Lalinca nënkryetar dhe Isuf Topilla sekretar. Të pranishmit i njoftova për punën që po bëjnë dhe që do të bëjnë në të ardhmen MKRS, gjithashtu kërkova bashkëpunim në fushën e Sportit dhe Kulturës, nga të pranishmit pranova një ftesë që të jem mysafir në konferencën e mësuesve të gjuhës amtare në Suedi dt.28.02.2018
- Turniri Tradicional i Shahut Kupa Adem Jashari Nën organizimin e Federatës së Shahut dhe Këshilli organizativ i qeverisë së Kosovës në kuadër të Epopesë së UÇK-së në ambientet e hotel Holiday u organizua ku merrnin pjesë edhe disa shtete Si Kroacia , Bullgaria, Maqedonia, Shqipëria dhe Sanxhaku. Në këtë turnir morën pjesë 200 shahist. Në emër të MKRS-së përshëndeta të pranishmit dhe organizatorët si Kryetarin e Federatës së Shahut Nysret Avdiu dhe drejtorin e DKRS-s nga Skenderaj, dt.04.02.2018

- Pjesëmarrës në emër të MKRS-së në turnirin ndërkombëtar për Femra të organizuar nga Klubi i Basketbollit Prishtina i mbështetur nga MKRS dhe disa sponsor, ky turnir është organizuar për nderë të 10-të vjetorit të pavarësisë së Kosovës, ku morën pjesë klubet Tirana, Nikshiqi Rilski dhe klubi i Prishtinës Probet dt.13.02.2018
- Takim i organizuar për pritjen e Damir Levacic mjeshtër ndërkombëtar i Shahut trajner i FIDE -së dhe anëtar i bordit të AIDF, i shoqëruar nga Kryetari i federatës së shahut të Kosovës z. Nysret Avdiu dhe mjeshtri ndërkombëtar nga Kosova Bedri Sadiku. Levacic ka shprehur interesimin për të investuar dhe zhvilluar Sportin e shahut në Kosovë dt.21.02.2018
- Takim punë i organizuar nga FAK (Federata e Atletikës së Kosovës) ku me kryetarin e Komunës së Junikut z. Agron Kuçin me bashkëpunëtorët e tij përfaqësuesit e klubeve të Atletikës si: Prizreni, Theranda, Malisheva, Rrogana, Trepça, Olimpi, Prishtina, Mitrovica, Trepça89, Llapi, Besa, Gërmia, Juniku si nikoqir si dhe atletët nga Shqipëria dhe Maqedonia ishte një takim pune rreth organizimit të vrapimit të Përvjetorit të Pavarësisë dt.17.02.2017
- I ftuar në emër të MKRS-së në Turnirin e Shahut në hotelin Ana benz të organizuar për 10-të vjetorin e pavarësisë nga Komuna e Fushë Kosovës, Kryetari i Kësaj Komune z. Burim Berisha dhe nga Kryetari i federatës së Shahut të Kosovës z. Nysret Avdiu me bashkëpunëtorë. Në emër të MKRS-së falënderova për këtë organizim tradicional të kësaj komune, njeherit kërkova nga klubet dhe FSH angazhim dhe punë sa më shumë në mënyrë që Kosova të prezantohet më denjësisht në gara ndërkombëtare, dt.19.02.2018
- Komuna e Gjakovë - Në sallën e shkollës së mesme të Lartë të muzikës “Prenk Jakova” u shfaq një dokumentar me titull – Një jetë më hendbollin – Mexhid Devaja dokumentar i përgatitur nga gazetari sportiv Artan Muhaxhiri. Në këtë dokumentar ishin zy. Ministër Rexhep Mazrreku, kryetari i komunës Adrian Gjini, anëtar i bordit të Kok-ut Avni Nuha, presidenti i federatës së Atletikës Halil Sylejmani, presidenti i federatës së karatesë Ismet Krasniqi, sekretari i federatës së volejbollit Valon Nikqi, anëtar i kryesisë së FAK Adrian Mazreku dhe përfaqësues të tjerë. Në këtë takim u vlerësua lartë puna e ish kryetarit të federatës së hendbollit Mexhid Devaja deri në pranimin e hendbollit në federatën ndërkombëtare të hendbollit dt.20.02.2018


- Takim i realizuar me Elis Badallaj udhëheqës i divizionit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Afrim Deliu zyrtar në Ministrinë e Diasporës. Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të aktiviteteve tona ndërministrore, biseduam për shumë tema, për organizimin e jetës sportive në diasporë në veçanti në Gjermani dhe Zvicërr që ka një organizim të mirë nga klubet sportive në veçanti në futboll. Do analizojmë dhe do shohim mundësitë e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të aktiviteteve dt. **22.02.2018**
- Takim konsultativ në MKRS me zv. Ministrin për punë dhe mirëqenien Sociale Çerkin Dukolli dhe zv. Ministër Burbuqe Bakija – Deva për çështje të trashëgimisë kulturore dhe çështje të rëndësishme për dy Ministrinë dt.**23.02.2018**
- Ishte për vizitë mësuesi i im, aktivisti i pa ndalur i çështjes kombëtare , ndër mësuesit e parë të shkollës shqipe në Suedi Nuhi Adem Mazreku, bashkë me Afrim Deliu zyrtar i lartë për Kulturë, Rini dhe Sport në diasporë, të shoqëruar nga drejtori i SH F M U të Malishevës Januz Mazreku dhe Ahmet Morina nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më këtë rast falënderova mësuesin Nuhi për punën që po e bënë në edukimin e nxënësve me mësimin plotësues në Suedi si dhe kontributin e përgjithshëm në lobimin e deritashëm për çështje kombëtare. Mësuesi Nuhi shumë ka ndihmua në pritjen, përcjelljen e aktivistëve të çështjes kombëtare, individëve, familjarëve por edhe institucioneve dhe për përfaqësuesve të institucioneve të Republikës së Kosovës. Ne si MKRS do ti mbështesim aktivitetet e diasporës duke respektuar ligjet në fuqi dhe rregulloret, si në Kulturë, Rini por edhe sporti do mbështetet përmes formave të ndryshme,dt. **17.03.2018**

1. Vizita të realizuara me Federata dhe Klube

1.1. Takim me DKRS në Malishevë dt. 26.01.2018

Ne këtë takim ishin: zv. Ministër Rexhep Mazreku, këshilltari i ministrit Daut Thaçi, inxhinieri i Infrastrukturës Sportive Refki Osmani, Nënkyetari i komunës Hajdin Berisha, drejtoresha e DKRS-së dhe përfaqësuesi i kompanisë së ndërtimit të stadiumit në Malishevë.

Në këtë takim u kërkua që të ndahen mjetet sa më shpejt që është e mundur për vazhdimin e punimeve në stadium pasi që tepihu është vendos mirëpo nuk është rregulluar si duhet, sipas pronarit të kompanisë dhe inxhinierit të infrastrukturës sportive nëse qëndron për një kohë të gjatë tepihu pa u bërë lidhja do të dëmtohet dhe është e vështir të jetë i përshtatshme për zhvillimin e ndeshjeve.



1.2. Federata Skitare e Kosovës dt.02.02.2018

Vizitë te kryetari i federatës Milaim Kelmendi (FSK) ku u trajtuan disa tema rreth zhvillimit dhe sukseseve të arritura.

Federate Skitare e Kosovës është duke bërë homologimin e shtigjeve me ekspert vendor dhe ndërkombëtar ku pas përfundimit të kësaj faze presim që në vendin tonë të zhvillohen gara me karakter ndërkombëtar.

- Kërkesa e federatës ishte që mundësisht mjetet e ndara për këtë federatë të lëshohen me kohë, ku si rezultat i kësaj po paraqitën probleme në realizimin e planit të punës dhe ushtrimit të aktiviteteve sportive.

Si rezultat i punës së bërë nga FSK Kosova për herë të parë ka arritur të jetë pjesë e lojërave olimpike pyeonchang. FSK ka gjithsej 26 klube të skitarisë



**FEDERATA SKITARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKI FEDERATION REPUBLIC OF KOSOVA**

1.3. Federata e Hendbollit e Kosovës dt.07.02.2018

Takim me kryetarin e FHK-s Eugen Saraçini dhe sekretarin Izet Gjinivci, në këtë takim u njoftuam për sukseset e arritura gjatë zhvillimit të garave ndër vite.

Pas një pune shumë vjeçare kemi arritur që Sporti i Hendbollit të ndërkombëtarizohet i pari në Kosovë, gjithashtu jemi duke punuar në vazhdimësi për të arritur sa më shumë suksese,

- Ndërtimi i sallës të jetë prioritet
- Financat janë një faktor i cili po ndikon që ne të kemi shumë probleme në realizimin e planit të punës pasi që mjetet të cilat na takojnë nuk po na ndahën me kohë.
- Infrastruktura është një problem tjetër i cili po na paraqet pengesa në zhvillim të aktiviteteve pasi që në salla gjatë dimrit mungon ngrohja dhe vije deri te ndërprerja e stërvitjeve.
- Ndriçimi jo i mirë është problem tjetër,




1.4. Federata e pingpongut e Kosovës dt.15.02.2018

Federata e pingpongut sikurse edhe federatat e tjera ka pengesa në zhvillimin e aktiviteteve të saj.


Kërkesat e kësaj federate ishin:

- Krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sidomos gjatë stinës së dimrit
- Mungesa e financimit ka bërë që në të kemi pasiguri në realizimin e projekteve, mirëpo ne jemi interesuar që të gjejmë mjete edhe jashtë ministrisë nga donatorët e ndryshëm me qëllim të realizimit të planit të punës
- Pagesat e vonuara janë ato të cilat neve si federatë na kushtojnë shumë për arsye se nëse je paraqitur si pjesëmarrës në një turne ndërkombëtar dhe nuk merr pjesë atëherë do të dënohesh nga organet ndërkombëtare.

Pjesëmarrja në kampionate evropiane është çelës për gara të nivelit botëror.



ITTF.com



WORLD
TABLE TENNIS
FOR ALL
DAY

Me 6 prill 2017, Sheshi Skenderbeu
Ora 11:00 deri 19:00



Fruomania



VLERA

1.5. Klubi i Futbollit Prishtina dt. 26.02.2018


Në këtë takim ishte i pranishëm Kryetari i FC Prishtinës z. Sokol Krasniqi dhe anëtarë të kryesisë së klubit. Sipas Kryetarit FC Prishtina është klubi i parë në Futboll i cili është licencuar, gjithashtu si klub kemi paguar mbi 600,000.00 Euro tatime.

Ne si klub kemi pasur shumë shpenzime pasi që ende nuk kemi stadium, ne kemi paguar për zhvillimin e ndeshjeve në qytet e tjera, gjithashtu kemi paguar edhe për stërvitje të lojtarëve, FC Prishtina i ka zhvilluar mbi 40 ndeshje ku prej tyre 20 janë derbi.

Për çdo ndeshje kemi paguar 400-600 €

Ndërsa për stërvitje kemi paguar 150 €

- Kërkesë e FC Prishtinës është ndërtimi i Stadiumit sa më shpejtë që është e mundur
- Ndërtimi i kampit stërvitor në Bërniceë, plani dhe të gjitha dokumentet përcjellëse janë të përgatitura dhe i është dorëzuar kabinetit të ministrit Kujtim Gashi.
- Shpenzimet e bëra të klubit KF Prishtina janë në vlerë 35,000.00 €, në këtë vlerë përfshihen të gjitha shpenzimet e bëra për zhvillimin e ndeshjeve, stërvitjet e klubit për këtë shumë nuk është përgjigjur askush.



1.6. K F 2 Korriku – Prishtinë dt.01.03.2018

Ky takim u realizua me përfaqësues të klubit të cilët na njoftuan për të arriturat, sfidat, problemet dhe vështirësitë e klubit.

Në këtë takim të pranishëm ishin: Rexhep Baholli – Kryetar i klubit dhe Shaban Baholli drejtor i klubit si dhe trajnerët e grup moshave të ndryshme


U njoftuam për historikun e klubit, rezultatet, punën në klub, puna me kategoritë e reja ku vlerësohet lartë puna që është bërë dhe që po bëhet në SH F 2 Korriku e cila vlerësohet si një ndër shkollat më të mira në Kosovë.

Nga ky takim patëm disa kërkesa si:

- Rregullimi i statusit të klubeve;
- Sqarimi i ekspertëve të ekonomisë nëpër komuna – ligji mbi sponsorizimin;
- Mundësia e dhënies së tokave në shfrytëzim për ndërtimin e qendrave stërvitore.

Sipas kryetarit Baholli SH.F. 2 Korriku është njëra ndër shkollat e cila ka arritur të nxjerrë shumë talent duke përfshirë grup - mosha të ndryshme edhe përkundër vështirësive që kemi ne asnjë herë nuk jemi ndalur dhe nuk do të ndalemi në punën tonë në këto kushte që i kemi tani për momentin kemi 10 ekiye garuese dhe shpresojmë të rrisim numrin e tyre në të ardhmen.

K.F.2 KORRIKU-PRISHTINË




1.7. Federata e Karatesë e Kosovës dt.02.03.2018

Federata e karatesë me punën e bërë dhe përkushtimin e anëtarëve të saj ka arritur shumë suksese duke qenë pjesë e lojërave ndërkombëtare siç ishte rasti në Rusi ku arritëm të ishim pjesë në këtë shtet ishim të përfaqësuar me Himn, dhe Flamur.

- Financimi i F.K është problem i cili po na paraqet probleme sidomos kur kemi të udhëtojmë në vende të tjera
- Kërkojmë të kemi në shfrytëzim zyre shtesë pasi që punojmë në kushte ku mungon hapësira dhe nuk kemi as ku ti vendosim dokumentet
- F.K ka nevojë për objekt sportiv i cili duhet të ketë edhe sallat ndihmëse
- Kemi udhëtuar në Spanjë në mënyrë jo të rregullt vetëm për të realizuar planin e punës
- Kemi filluar vitin 2018 me minus 55,000.00 €
- Sporti i karatesë është lënë anash nga mediat

Federata e Karatesë me punën e saj ka arritur të hyj në sistem të pikëve Olimpikë, garuesit tanë kanë arritur të fitojnë medalje në të gjitha nivelet e garave.

Në vitin 2022 FK është organizator i kampionatit evropian në Prishtinë ku do jenë 1700 garues dhe 2000 pjesëmarrës të tjerë.




1.8. Federata e Atletikës e Kosovës dt.05.03.2018

Në këtë takim u pritëm nga Kryetari i kësaj federate Halil Sylejmani dhe sekretari Abdurrahman Shkodra, sipas kryetarit vizita e bërë ne këtë federatë është vizita e parë që i është bërë ndonjëherë nga ndonjë përfaqësues i institucioneve shtetërore.

Ne si federatë kemi kryesinë e cila përbëhet nga 11 anëtarë dhe të gjitha vendimet që merren janë në pajtim me rregulloret të cilat i kemi punuar dhe miratuar nga komisioni profesional.

Përfaqësuesit e federatës së Atletikës patën disa kërkesa si:

- Rregullimi i shtegut të Atletikës në Mitrovicë
- Të ndahen 3 zyre në stadiumin Adem Jashari
- Ndërtimi i shtegut të Atletikës për zhvillimin e garave ndërkombëtare ku si mungesë e këtij shtegu në vitin 2017 kemi humbur dy gara ndërkombëtare vlera e të cilave është rreth 20,000€



1.9. Federata e Boksit e Kosovës dt.06.03.2018

Takimi u realizua me Sekretarin e FBK z. Mehmet Bogujevci i cili na njoftoi për punën që po e bënë Federata e Boksit. Sipas Sekretarit kemi një gjendje jo të kënaqshme në klube por jemi duke punuar intenzivisht për tejkalimin e vështirësive.

Ne si FBK kemi pasur disa suksese me sportistët tanë të cilët kanë arritur të jenë pjesë e kampionateve evropiane dhe të fitojnë medalje në këto gara. Ne si federatë jemi ndër federatat më të rregullta sa i përket dhënies së llogaridhënies në ministri. FBK ka gjithsej 19 klube të Boksit dhe kemi mbi 700 garues të regjistruar në boks.

- Kërkojmë përmirësimin e kushteve për zhvillimin e Sportit të Boksit si dhe
- Kërkojmë që mjetet e ndara nga Ministria të lëshohen me kohë.




2. Fakulteti i Shkencave Sportive – Prishtinë dt.08.03.2018

Takim i realizuar me Prof. Dr. Musa Selimi Dekan në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, si dhe Prodekan dr. Hasim Rushiti, me ç'rast na njoftoi për punën, aktivitetet, rezultatet dhe kushtet e punës në fakultet.

Natyrisht gjatë vizitës pamë ambientet e fakultetit ku mbahen ligjëratat, pastaj vizituam sallën e rinovuar të gjimnastikës, Sallën e sporteve dhe ambientet e brendshme të këtij tempulli të shkencave sportive. U potencua se ky fakultet ka nevojë për hapësira më të mëdha të klasave, hapësira sportive dhe në ambientet e jashtme për sportet me dorë por edhe në terren të hapur për futboll.

- U kërkua mundësia e menaxhimit të palestrës sportive I Tetori nga ky fakultet
- Dhënia e hapësirës për shfrytëzim mbrapa fakultetit të shkencave sportive për të zhvilluar lojë gjate verës në teren të hapur.



3. Komuna e Junikut takim i realizuar më dt.14.03.2018

Në këtë takim të realizuar me Kryetarin e Komunës së Junikut u njoftuam për punën dhe gjendjen në këtë komunë, gjithashtu u njoftuam për objektet e shumta që i ka kjo komunë, një karakteristikë të veçantë e kësaj komune janë kullat dhe nga ky takim Kryetari kërkoi mbështetje dhe financim për ruajtjen e kësaj vlere të rëndësishme të trashëgimisë.

Kryetari shprehi shqetësim për arsye të mos përkrahjes me mjete financiare këtë komunë dhe kërkoi që në të ardhmen të mos përsëritet një praktikë e tillë, përveç kësaj si komunë jemi anashkaluar edhe me projekte, sipas Kryetarit si Komunë e kemi plan për Trashëgimi dhe Ekologji.



4. Komuna e Klinës takim i realizuar më dt.15.03.2018

Takim me Kryetarin Zenun Elezaj dhe me drejtorin e DKRS-s Skënder Merturi.

Nga ky takim i realizuar kryetari na njoftoi për gjendjen aktuale në Komunën e Klinës dhe për projektet që do të realizoi në të ardhmen kjo komunë. Sipas drejtorit të DKRS-s në këtë komunë ne jemi duke realizuar planin për ndërtimin e Qendrës Kulturore i cili ka mbetur ende i pa përfunduar për arsye të mungesës së mjeteve financiare është një projekt shumë me rëndësi për ne si Komunë dhe për rinin në veçanti, gjithashtu zona arkeologjike përbën një pjesë me rëndësi dhe komuna do të interesohet për ruajtjen e kësaj zone që të mos dëmtohet.

- Ne kërkojmë përkrahjen e të gjitha klubeve sportive
- Kërkojmë që palestra të pajiset me elemente të stërvitjes për sportistët
- Kërkojmë mbështetje për vazhdim të hulumtimit në zonën arkeologjike pasi që komuna nuk ka mjete të mjaftueshme për të vazhduar me hulumtim
- Kërkojmë ndërtimin e një fushe ndilumëse.

